



KUVENDI KOMUNAL PRISHTINE * MUNICIPALIT ASSEMBLY PRISHTINA * SKUPSTINA OPSTINA PRISTINA

Në bazë të nenit 3, par.1, pika b të Rregullores mbi vetëqeverisjen e komunave të Kosovës nr. 2000/45, të dt 11 gusht 2000, dhe të nenit 19, par.1, pika b të Statutit dhe rregullave të procedurës të Komunës së Prishtinës, të dt.16.3.2001, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 24.07.2007, merr

VENDIM
MBI CAKTIMIN E LOKACIONIT PËR NDËRTIMIN E OBJEKTIT TË SELISË
SË LDK-së NË LAGJEN “LAKËRISHTA” NË PRISHTINË

Neni 1

Miratohet Vendimi mbi caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit të Selisë së LDK-së në lagjen “Lakërishta” në Prishtinë.

Neni 2

Lokacioni për ndërtimin e objektit, sipas këtij vendimi, përfshihet në pjesët e ngastrës 6113/1 KK Prishtinë, të evidencuar në fletën poseduese nr.10318, në një sipërfaqe rreth 30.00 arë.

Neni 3

Lokacioni i cekur në nenin 1 dhe 2 të këtij vendimi, jepet në shfrytëzim për kohë të pacaktuar.

Neni 4

Ky vendim paraqet bazë për dhënien e pëlqimit në lokacionin, lëshimin e lejes urbanistike dhe lejimin e ndërtimit të objektit investiv për të cilin është caktuar lokacioni sipas këtij vendimi.

Neni 5

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Bordi i drejtorëve i Komunës së Prishtinës.

Drejtorati i Planifikimit, Urbanizmit dhe i Ndërtimit dhe Drejtorati i Kadastrit dhe i Gjeodezisë i Komunës së Prishtinës, do të kryejnë veprime nga përgjegjësitë e tyre të caktuar për realizimin e këtij vendimi.

Neni 6

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS

№ 01. 353-310, më 24.07.2007

KRYETARI I KUVENDIT
Ismet Beqiri